

ALLEA

ALL European
Academies



integrity | in'
1 the quality of being h
integrity.

Kodi European i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor

BOTIM I RISHIKUAR

Kodi Europian i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor
Botim i rishikuar

ALLEA - All European Academies
c/o Berlin-Brandenburg Akademia e Shkencave dhe e Studimeve Humane
Jaegerstr. 22/23
10117 Berlin, Germany

secretariat@allea.org
www.allea.org

Formatimi grafik: Susana Irlas
Piktura e kapakut: iStock

©ALLEA - All European Academies, Berlin 2018

Të gjitha të drejtat e autorit janë të rezervuara. Rishpërndarja, përfshi edhe në formë ekstraktesh, lejohet për qëllime arsimore, shkencore dhe private, kur citohet burimi (nëse nuk është shprehur në formë tjetër në mënyrë eksplicite nga artikulli). Për qëllime biznesi duhet kërkuar leje nga ALLEA.

Disclaimer:

Please note that while great care was taken to ensure the accuracy of the present translation of the European Code of Conduct for Research Integrity some slight deviation in meaning may be possible. Please refer to the original English-language version of [The European Code of Conduct for Research Integrity](#), published by ALLEA in Berlin in 2017, for the precise wording.

Acknowledgements:

ALLEA would like to thank the Academy of Sciences of Albania for the translation and the additional review on the precise research integrity language.

Përmbajtja

Hyrje	3
1. Parimet	4
2. Praktika të mira kërkimi shkencor	5
3. Shkelje të integritetit të kërkimit	9
Aneksi 1: Burimet kyçe	12
Aneksi 2: Procesi i rishikimit dhe lista e palëve të interesit	14
Aneksi 3: Grupi i Përhershëm i Punës i ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën	16

Hyrje



Kerkimi është sfida për dijet e përfuara falë të menduarit dhe studimit sistematik, vëzhgimit dhe eksperimentimit. Disiplinat e ndryshme mund të përdorin qasje të ndryshme, por ato i bashkon motivimi për të zhvilluar të kuptuarit e vetes sonë dhe të botës ku jetojmë. Prandaj "Kodi evropian i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor" zbatohet gjatë kërkimit në të gjitha fushat e shkencës dhe të dijes.

Kërkimi është një ndërmarrje e përbashkët, që kryhet në mjediset akademike, në industri apo në mjedise të tjera. Kërkimi përfshin bashkëpunim, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që shpesh i kapërcen kufijtë socialë, politikë dhe kulturorë. Ai ngrihet mbi bazë të lirisë për të përcaktuar çështjet e kërkimit, për të zhvilluar teori, për të mbledhur materiale empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme. Prandaj, kërkimi del prej punës së komunitetit të kërkuesve dhe, në variantin ideal, zhvillohet në mënyrë të pavarur nga presioni i partive drejtuese, ose nga interesa ideologjike, ekonomike apo politikë.

Një përgjegjësi themelore e komunitetit të kërkimit shkencor është të formulojë parimet dhe kriteret e etikës së kërkimit, për të rritur sa më shumë cilësinë dhe forcën e tij dhe t'u përgjigjet në mënyrën e duhur kërcënimeve apo shkeljeve të

integritetit.

Qëllimi parësor i këtij Kodi është të ndihmojë në realizimin e kësaj përgjegjësie dhe t'i shërbejë komunitetit të kërkimit si një kornizë për vetërregullim. Ai përshkruan përgjegjësitë profesionale, ligjore dhe etike, dhe pohon rëndësinë e kuadrit institucional ku organizohet kërkimi. Prandaj ky Kod është i përshtatshëm dhe i aplikueshëm për kërkimin me financim publik apo për kërkimin shkencor privat, duke pohuar kufizimet e ligjshme në zbatimin e tij. Interpretimi i vlerave dhe parimeve që rregullojnë kërkimin, mund të ndikohet nga zhvillimet sociale, politike ose teknologjike dhe nga ndryshimet në mjedisin e kërkimit. Për këtë arsye një kod i sjelljes është një dokument i gjallë që përditësohet vazhdimisht dhe që lë vend për diferenca lokale apo kombëtare në zbatimin e tij.

Kërkuesit, akademitë, shoqatat e dijes, organizatat që kryejnë kërkim publik dhe privat, botuesit dhe organet e tjera të lidhura me të kanë secili përgjegjësitë e veta për t'i vëzhguar dhe për t'i promovuar këto praktika dhe parimet mbi të cilat janë ngritur ato.

1. Parimet



Praktikat e mira të kërkimit shkencor bazohen në parimet themelore të integritetit të kërkimit. Ato i orientojnë kërkuesit në punën e tyre si dhe në angazhimin e tyre me sfidat praktike, etike dhe intelektuale që janë në thelb të kërkimit.

Këto parime janë:

- **Garancia** për cilësinë e kërkimit, pasqyruar në konceptin, metodologjinë, analizën dhe përdorimin e burimeve.
- **Ndershmëria** në zhvillimin, ndërmarrjen, shqyrtimin dhe komunikimin e kërkimit në një mënyrë transparente, të drejtë, të plotë dhe të paanshme.
- **Respekti** për kolegët, pjesëmarrësit në kërkim, shoqërinë, ekosistemet, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.
- **Përgjegjshmëria** për kërkimin që nga ideja deri në botim, për menaxhimin dhe organizimin e tij, mbikëqyrjen e udhëheqjen, dhe për impakte më të gjera.

2. Praktika të mira kërkimi



Praktikat e mira të kërkimit përshkruhen në kontekstet e mëposhtme:

- Mjedisin e kërkimit,
- Trajnimin, mbikëqyrjen dhe udhëheqjen,
- Procedurat e kërkimit,
- Masat mbrojtëse,
- Menaxhimin dhe praktikatat e të dhënave,
- Të punuarit në bashkëpunim,
- Botim dhe shpërndarje,
- Shqyrtimin, vlerësimin dhe redaktimin.

2.1 Mjedisin e kërkimit

- Organizatat dhe institucionet kërkimore promovojnë popullaritetin për shkencën dhe sigurojnë një kulturë mbizotëruese të integritetit kërkimor.
- Organizatat dhe institucionet kërkimore demonstrojnë udhëheqje me procedura dhe politika të qarta mbi praktikën e mirë të kërkimit shkencor dhe mbi trajtimin e duhur dhe transparent të shkeljeve.
- Organizatat dhe institucionet kërkimore mbështesin infrastrukturën e duhur për menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe materialeve të kërkimit në të gjitha format e tyre (që përfshijnë të dhëna sasiore e cilësore, protokolle, procese, dokumente e produkte të

tjera kërkimore të shoqëruara me të dhënat shpjeguese përkatëse), që janë të nevojshme për riprodhueshmërinë, për mundësinë e ndjekjes së rrjedhave dhe për përgjegjshmërinë.

- Organizatat dhe institucionet kërkimore inkurajojnë dhe shpërblejnë praktikatat e hapura dhe të riprodhueshme lidhur me punësimin dhe promovimin e kërkuesve.

2.2 Trajnimi, mbikëqyrja dhe udhëheqja

- Organizatat dhe institucionet kërkimore garantojnë që kërkuesit të marrin trajnimin rigoroz në konceptimin, metodologjinë dhe analizën e kërkimit.
- Organizatat dhe institucionet kërkimore zhvillojnë trajnim të duhur dhe të përshtatshëm në etikë dhe integritet kërkimi dhe sigurojnë që të gjithë të interesuarit të ndërgjegjësohen për rregulloret dhe kodet përkatëse.
- Kërkuesit në mbarë rrugën e karrierës së tyre që nga më të rinjtë te më të vjetrit, trajnohen mbi etikën dhe integritetin e kërkimit.
- Kërkuesit më të vjetër, udhëheqësit dhe drejtuesit e kërkimit orientojnë dhe këshillojnë anëtarët e ekipit të tyre të

kërkimit dhe ofrojnë trajnim dhe orientim specifik për të zhvilluar në mënyrën e duhur konceptin dhe strukturën e aktivitetit të tyre kërkimor, dhe për të nxitur kulturën e integritetit të kërkimit.

2.3 Procedurat e kërkimit

- Kërkuesit marrin parasysh stadin aktual në zhvillimin e ideve kërkimore.
- Kërkuesit konceptojnë, kryejnë, analizojnë dhe dokumentojnë kërkimin në mënyrë të kujdesshme dhe të mirëshqyrtuar.
- Kërkuesit përdorin në mënyrën e duhur dhe të ndërgjegjshme fondet e kërkimit.
- Kërkuesit botojnë rezultatet dhe interpretimet e kërkimit në mënyrë të hapur, transparente dhe të saktë dhe respektojnë konfidencialitetin e të dhënave apo gjetjeve kur kjo u kërkohet në mënyrë legjitime.
- Kërkuesit raportojnë rezultatet e tyre në përputhje me standardet e disiplinës dhe, atje ku është e zbatueshme, mund të verifikohen dhe të riprodhohen.

2.4 Masat mbrojtëse

- Kërkuesit veprojnë në përputhje me kodet dhe rregulloret përkatëse në disiplinën e tyre.
- Kërkuesit i trajtojnë subjektet e kërkimit, qofshin këto njerëzore, shtazore, kulturore, biologjike, mjedisore apo fizike, me respekt dhe kujdes, dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe etike.
- Kërkuesit kanë konsideratën e duhur për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit, të bashkëpunëtorëve dhe të

personave të tjerë të lidhur me kërkimin e tyre.

- Protokollet e kërkimit marrin parasysh dhe janë të ndjeshme ndaj diferencave përkatëse në moshë, gjini, kulturë, besim fetar, origjinë etnike dhe klasë sociale.

- Kërkuesit njohin e menaxhojnë rreziqet dhe dëmet e mundshme lidhur me kërkimin e tyre.

2.5 Menaxhimi dhe praktikat e të dhënave

- Kërkuesit, institucionet dhe organizatat kërkimore sigurojnë kujdesin dhe integritimin e të gjitha të dhënave dhe materialeve kërkimore, përfshirë edhe ato të pabotuara, me ruajtje të sigurt për një periudhë të arsyeshme.
- Kërkuesit, institucionet dhe organizatat kërkimore sigurojnë që qasja në të dhëna të jetë sa më i hapur që të jetë e mundur, dhe aq i mbyllur sa të jetë e nevojshme, dhe ku është e përshtatshme, në linjë me parimet FAIR (*Findable, Accessible, Interoperable and Re-usable* – të gjetshme, të arritshme, ndërvepruese dhe të ripërdorshme) për menaxhimin e të dhënave.
- Kërkuesit, institucionet dhe organizatat kërkimore sigurojnë transparencë mbi mënyrën se si të sigurojnë qasje ose t'i bëjnë të përdorshme të dhënat dhe materialet kërkimore të tyre.
- Kërkuesit, institucionet dhe organizatat kërkimore i pranojnë të dhënat si produkte legjitime dhe të citueshme të kërkimit.
- Kërkuesit, institucionet dhe organizatat

kërkimore sigurojnë që çdo kontratë apo marrëveshje për rezultatet e kërkimit, të përfshijë mundësi të barabarta dhe të ndershme për menaxhimin e përdorimit të tyre, pronësinë, dhe/ose mbrojtjen e tyre nën të drejtat intelektuale të autorit.

2.6 Të punuarit në bashkëpunim

- Të gjithë partnerët në bashkëpunimet kërkimore marrin përgjegjësi për integritetin kërkimor.
- Të gjithë partnerët në bashkëpunimet kërkimore, bien dakord qysh në fillim mbi qëllimet e punës kërkimore dhe mbi procesin për të komunikuar kërkimin e tyre në mënyrë sa më transparente dhe të hapur që të jetë e mundur.
- Të gjithë partnerët në bashkëpunimet kërkimore, bien dakord qysh në fillim mbi atë çfarë presin dhe mbi standardet për integritetin kërkimor, mbi ligjet dhe rregulloret që do të zbatohen, mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit për bashkëpunëtorët dhe mbi procedurat për të trajtuar konfliktet dhe rastet e ndryshme të shkeljeve të sjelljes sipas kodit.

- Të gjithë partnerët në bashkëpunimet kërkimore janë të informuar dhe janë konsultuar siç duhet lidhur me dërgimin për botim të rezultateve të kërkimit.

2.7 Botimi dhe shpërndarja

- Të gjithë autorët janë plotësisht të ndërgjegjshëm mbi sekuencën e autorësisë, duke njohur se autorësia në vetvete bazohet në një kontribut domethënës në konceptimin e kërkimit, mbledhjes së të dhënave përkatëse, ose

analizës ose interpretimit të rezultateve.

- Autorët sigurojnë që puna e tyre të jetë e arritshme për kolegët e tyre në mënyrë të hapur, transparente, të saktë dhe në kohën e duhur, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet dhe bihet dakord ndryshe, dhe janë të ndershëm në komunikimin e tyre me publikun e përgjithshëm dhe në median sociale e tradicionale.

- Autorët pranojnë dhe njohin punën e rëndësishme dhe kontributet intelektuale të të tjerëve, përfshirë bashkëpunëtorët, asistentët dhe financuesit, që kanë ndikuar në kërkimin e raportuar në formën e përshtatshme, dhe citojnë punën në fjalë në mënyrë korrekte.

- Të gjithë autorët paraqesin ose bëjnë të njohur çdo konflikt interesi apo mbështetje financiare apo të ndonjë lloji tjetër për kërkimin ose për botimin e rezultateve.

- Autorët dhe botuesit bëjnë korrigjimet ose e tërheqin punimin nëse është e nevojshme, sipas procedurave të qarta dhe me arsye të parashtruara, dhe autorët vlerësohen për nxjerrjen e korrigjimeve të menjëhershme pas botimit të kërkimit.

- Autorët dhe botuesit i konsiderojnë rezultatet negative po aq të vlefshme sa gjetjet pozitive për botim dhe shpërndarje.

- Kërkuesit aderojnë në të njëjtat kritere si ato detajuar më sipër, edhe kur ata botojnë në një revistë me abonim, në një revistë me qasje të hapur apo në ndonjë formë tjetër botimi alternativ.

2.8 Shqyrtimi, vlerësimi dhe redaktimi

- Kërkuesit e marrin seriozisht angazhimin e tyre në komunitetin e kërkimit, duke marrë pjesë në referenca, recensim dhe vlerësim.
- Kërkuesit shqyrtojnë dhe vlerësojnë dërgimet për botim, financimet, emërimet, ngritjet në detyrë apo shpërblimet në mënyrë transparente dhe të justifikueshme.
- Vlerësuesit dhe redaktorët që janë në konflikt interesi tërhiqen nga përfshirja në vendimet mbi botimin, financimin, emërimin, promovimin / ngritjen në pozicion apo shpërblimin.
- Vlerësuesit ruajnë konfidencialitetin me përjashtim të rasteve kur ka miratim paraprak për bërjen publike.
- Vlerësuesit dhe redaktorët respektojnë të drejtën e autorëve dhe aplikuesve dhe kërkojnë leje për të përdorur ide, të dhëna apo interpretime të paraqitura.

3. Shkeljet e integritetit të kërkimit shkencor



Është e një rëndësie jetike që kërkuesit të zotërojnë njohuritë, metodologjitë dhe praktikët etike të lidhura me fushën e tyre të kërkimit. Pamundësia për të ndjekur praktikët pozitive të kërkimit përbën shkelje të përgjegjësive profesionale. Kjo dëmton proceset e kërkimit, degradon marrëdhëniet mes kërkuesve, minon besimin në kërkim dhe besueshmërinë e tij, përbën humbje të burimeve dhe mund t'i ekspozojë subjektet e kërkimit, përdoruesit, shoqërinë ose mjedisin përballë kërcënimeve të panevojshme.

3.1 Sjellje dhe praktika të papranueshme në kërkimin shkencor

Sjellja e papranueshme përkufizohet tradicionalisht si fabrikim, falsifikim apo plagjiaturë (që quhet edhe kategorizim FFP) në propozimin, kryerjen apo vlerësimin e kërkimit, ose në raportimin e rezultateve të kërkimit:

- *Fabrikimi* është sajimi i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta.
- *Falsifikimi* është manipulimi i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshimi, heqja apo shmangia e të dhënave apo rezultateve pa justifikim.
- *Plagjiatura* është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit origjinal, duke shkelur

në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.

Këto tri forma shkeljesh konsiderohen në mënyrë të veçantë serioze përderisa ato prishin të dhënat e kërkimit. Ka edhe shkelje të tjera të praktikës pozitive të kërkimit që dëmton integritetin e procesit të kërkimit apo të kërkuesve. Përveç shkeljeve të drejtpërdrejta të praktikave pozitive të kërkimit parashtruar në këtë Kod të Sjelljes, shembuj të praktikave të tjera të papranueshme përfshijnë, por nuk kufizohen me:

- Manipulimi i autorësisë apo denigrimi i rolit të kërkuesve të tjerë në botime.
- Ribotimi i pjesëve thelbësore të botimeve të veta më të hershme, pa cituar origjinalin ('vetëplagjiarizëm').
- Citimi në mënyrë përzgjedhëse për të zmadhuar gjetjet e veta ose për të kënaqur redaktorët apo kolegët.
- Fshehja e rezultateve të kërkimit.
- Lejimi i financuesve / sponsorizuesve të rrezikojnë pavarësinë gjatë procesit të kërkimit ose në raportimin e rezultateve, me qëllim krijimin e konteksteve të njëanshme.
- Zgjerimi në mënyrë të panevojshme i bibliografisë së një studimi.
- Akuzimi i një studiuesi për sjellje të papranueshme apo shkelje të tjera në mënyrë

keqdashëse.

- Keqprezantimi i arritjeve të kërkimit.
- Tejmadhimi i rëndësisë dhe i zbatueshmërisë praktike të gjetjeve.
- Vonesa apo pengimi i punës së kërkuesve të tjerë.
- Keqpërdorimi i pozitës më të lartë për të inkurajuar shkelje të integritetit kërkimor.
- Anashkalimi i shkeljeve të mundshme të integritetit kërkimor kryer nga të tjerë ose mbulimi me përgjigje të papërshtatshme për sjelljet e papranueshme apo shkeljet e tjera nga institucionet.
- Themelimi apo mbështetja e revistave që minojnë kontrollin e cilësisë së kërkimit [‘revista grabitqare (predatory journals)’].

Në formën e tyre më serioze, praktikat e papranueshme janë të sanksionueshme, por gjithsesi duhet bërë çdo përpjekje për t'i parandaluar, për t'i dekurajuar dhe për t'i ndaluar ato nëpërmjet trajnimit, mbikëqyrjes dhe mentorimit dhe nëpërmjet zhvillimit të një mjedisi kërkimor pozitiv dhe mbështetës.

3.2 Trajtimi i shkeljeve dhe akuzat për sjellje të papranueshme

Ka ndryshime mes udhëzimeve kombëtare dhe institucionale mbi mënyrën e trajtimit të shkeljeve dhe akuzave për sjellje të papranueshme në vende të ndryshme. Megjithatë, është gjithmonë në interes të shoqërisë dhe komunitetit të kërkimit shkencor që shkeljet të trajtohen në mënyrë të qëndrueshme dhe transparente. Është e nevojshme që parimet e mëposhtme të përfshihen në çdo proces verifikimi.

Integriteti

- Proceset e verifikimit janë të paanshme, gjithëpërfshirëse dhe të kryera në mënyrë të përshtatshme dhe të përshtatur, pa cenuar saktësinë, objektivitetin apo plotësinë.
- Palët e përfshira në procedurë deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të dalë gjatë verifikimit.
- Merren masa për të siguruar që verifikimet të kryhen deri në daljen e përfundimeve.
- Procedurat kryhen në mënyrë konfidenciale me qëllim mbrojtjen e atyre që janë të përfshirë në verifikim.
- Institucionet mbrojnë të drejtat e "bilbilfryrësve" (personave që zbulojnë informacionet mbi shkeljet) gjatë verifikimit dhe garantojnë që të mos rrezikohen perspektivat e karrierës së tyre.
- Procedurat e përgjithshme për të trajtuar shkeljet e praktikës pozitive janë të disponueshme publikisht dhe të shfrytëzueshme për të gjithë për të garantuar transparencë dhe uniformitet.

Paanshmëria

- Verifikimet kryhen me një proces të përshtatshëm dhe në paanshmëri me të gjitha palët.
- Personat e akuzuar për sjellje të papërshtatshme njihen me detajet e plota të akuzave dhe u lejohet një proces i drejtë i paanshëm për t'iu përgjigjur akuzave dhe për të paraqitur prova.
- Ndërmerret veprim kundër personave për

të cilët është ngritur një akuzë për sjellje të papranueshme, në mënyrë proporcionale me shkallën e shkeljeve.

- Ndërmerret veprim i përshtatshëm rehabilitues kur kërkuesit çlirohen nga çdo akuzë për shkelje.
- Çdo i akuzuar për sjellje të papranueshme prezumohet i pafajshëm derisa të provohet e kundërta.

Aneks 1: Burimet kyçe

All European Academies (2013). "Ethics Education i Science". Grupi i Përhershëm i Punës i ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën.

www.allea.org/wp-content/uploads/2015/07/Statement_Ethics_Edu_web_final_2013_10_10.pdf [Aksesuar 14/03/2017]

AllTrials: Regjistrimi i përpjekjeve dhe Platforma e Raportimit.
<http://www.alltrials.net/find-out-more/> [Aksesuar 14/03/2017]

Shoqata Amerikane për Avancimin e Shkencës (2017). Deklarata e Brukselit: Etika dhe Parimet për Shkencën dhe Parimet për Shkencën & Politikëbërja për Shoqërinë.

<http://www.sci-com.eu/main/docs/Brussels-Declaration.pdf?58b6e4b4> [Aksesuar në 14/03/2017]

Komiteti i Etikës së Botimit (Committee on Publication Ethics - COPE). Udhëzimet.
<http://publicationethics.org/resources/guidelines> [Aksesuar 14/03/2017]

Grupi i Sintezës së Citimeve të të Dhënave, Martone M. (ed.) (2014). Deklarata e Përbashkët e Parimeve të Citimeve të të Dhënave. San Diego, CA: FORCE11.

<https://www.force11.org/group/joint-declaration-data-citation-principles-final> [Aksesuar 15/01/2017]

Rrjeti EQUATOR: Udhëzimet e raportimit për të rritur cilësinë dhe transparencën e kërkimit në shëndetësi.

<https://www.equator-network.org/> [Aksesuar 13/03/2017]

EUDAT. Infrastrukturë bashkëpunuese për të dhënat: Udhëzimet mbi menaxhimin e të dhënave.

<https://eudat.eu/data-management> [Aksesuar 15/01/2017]

Partneriteti NdërAkademik (InterAcademy Partnership – IAP) (2016). "Të bësh Shkencë Globale: Një udhëzim për Sjellje të Përgjegjshme në Ndërmarrjen Globale të Kërkimit". Princeton University Press.

<http://interacademycouncil.net/24026/29429.aspx> [Aksesuar 15/01/2017]

Komiteti Ndërkombëtar i Redaktorëve të Revistave Mjekësore. Përcaktimi i Rolit të Autorëve dhe Kontribuesve.

<http://www.icmje.org/recommendations/browse/roles-and-responsibilities/defining-the-role-of-authors-and-contributors.html> [Aksesuar 15/01/2017]

Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) dhe Forumi Global për Shkencën (2007). Praktikrat më të mira për të Siguruar Integritet Shkencor dhe për të Parandaluar Shkeljet. Aneks 1: Key Resources.

<https://www.oecd.org/sti/sci-tech/40188303.pdf> [Aksesuar 15/01/2017]

Aleanca e të Dhënave të Kërkimit (Research Data Alliance – RDA) (2016). RDA/WDS Rekomandimit e Grupit të Punës mbi Fluksin e Publikimit të të Dhënave.

<http://dx.doi.org/10.15497/RDA00004> [Aksesuar 15/01/2017]

Aleanca e të Dhënave të Kërkimit (Research Data Alliance – RDA) (2016). Rekomandime të Grupit të Punës mbi Ndërveprueshmërinë për Regjistrin e Përshkrimit të të Dhënave.

<http://dx.doi.org/10.15497/RDA00003> [Aksesuar 15/01/2017]

Akademia e Mbretërisë së Bashkuar e Shkencave Mjekësore (2015). Perspektiva mbi 'Konfliktin e Interesave'.

<https://acmedsci.ac.uk/file-download/41514-572ca1ddd6cca.pdf> [Aksesuar në 13/03/2017]

Wilkinson MD et al. (2016). Parimet Orientuese TË NDERSHME për përgjegjshmërinë dhe menaxhimin e të dhënave shkencore, Të dhëna shkencore 3:160018 doi: 10.1038/sdata.2016.18

<http://www.nature.com/articles/sdata201618> [Aksesuar 15/01/2017]

Konferenca Botërore për Integritetin kërkimor (World Conference on Research Integrity - WCRI) (2013). Deklarata e Montrealit mbi Integritetin kërkimor në Bashkëpunimet për Kërkimin në kapërcyell të fushave të shkencës.

<http://www.researchintegrity.org/Statements/Montreal%20Statement%20English.pdf> [Aksesuar 05/01/2017]

Konferenca Botërore për Integritetin kërkimor (World Conference on Research Integrity - WCRI) (2010). Deklarata e Singaporit mbi Integritetin kërkimor.

www.singaporestatement.org/statement.html [Aksesuar 15/01/2017]

Aneks 2: Procesi i rishikimit dhe lista e palëve të interesit

Procesi i rishikimit

Ky dokument bazohet në "Kodin evropian i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor" përpunuar në 2011 nga ALLEA dhe nga Fondacioni Evropian i Shkencës (European Science Foundation – ESF). Është një dokument i gjallë që do të rishqyrtohet çdo tre deri pesë vjet dhe do të rishikohet sipas nevojës për të marrë në konsideratë shqetësime që dalin në vijim, në mënyrë që të mund të vazhdojë t'i shërbejë komunitetit të kërkimit shkencor si një kuadër i praktikave pozitive të kërkimit shkencor.

Rishikimi aktual motivohet nga zhvillimet, ndër të tjera në: kontekstin rregullator dhe atë të financimit të kërkimit shkencor, përgjegjësitë institucionale; komunikimet shkencore, procedurat e shqyrtimit, botimet me qasje të hapur, përdorimi i bazave të të dhënave dhe përdorimi i medias sociale dhe përfshirjes qytetare në kërkim. Me nismën e Grupit të Përhershëm të Punës të ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën, rishikimi përfshiu konsultime të gjera mes palëve kryesore të interesit në kërkimin shkencor evropian si publik edhe privat, për të siguruar një pronësi intelektuale të përbashkët.

Lista e palëve të interesit

Organizatat shumëpalëshe të palëve të interesit që kanë dhënë reagimin* dhe / ose që morën pjesë në takimet konsultuese të palëve të interesit në Bruksel në nëntor 2016+:

- BusinessEurope*+
- Centre for European Policy Studies (CEPS)*
- Committee on Publication Ethics (COPE)*+
- Conference on European Schools for Advanced Engineering Education and Research (CESAER)*+
- DIGITALEUROPE*+
- EU-LIFE*+
- European Association of the Molecular and Chemical Sciences (EUCHEMS)*+
- European Association of Research and Technology Organisations (EARTO)*+
- European Citizen Science Association (ECSA)*
- European Commission*+
- European Group on Ethics in Science and Technologies (EGE)*
- European Network of Research Integrity Offices (ENRIO)*+
- European University Association (EUA)*+
- Euroscience*+
- FoodDrinkEurope*+
- Global Young Academy (GYA)*+
- League of European Research Universities (LERU)*+
- Open Access Infrastructure for Research in Europe (OpenAIRE)*+
- Open Access Scholarly Publishers Association (OASPA)+
- Sense about Science*
- Science Europe*+
- Young European Associated Researchers (YEAR)*+
- Young European Research Universities Network (YERUN)*+

Aneks 3: Grupit i Përhershëm i Punës i ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën

Grupi i Përhershëm i Punës i ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën u mor me një gamë të gjerë çështjesh, si "të brendshme" (brenda komunitetit shkencor) dhe "të jashtme" (marrëdhëniet mes shkencës dhe shoqërisë). Përderisa konsideratat etike kanë qenë një përbërës thelbësor në konsolidimin e një Europe të bashkuar, dhe gjithashtu në krijimin e ALLEA-s, Grupi i Përhershëm i Punës i ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën u ngrit për të sjellë bashkë ekspertë nga akademitë në mbarë Europën dhe t'u japë atyre një platformë për debat të vazhdueshëm mbi etikën e kërkimit dhe integritetin e kërkimit.

Grupi i Përhershëm i Punës i ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën i ka shtrirë kapacitetet dhe aktivitetet e veta në vitet e fundit, me qëllim që të përmbushë në mënyrën e duhur misionin e vet për mendime të matura mbi çështje të tilla si integriteti i kërkimit, edukimi mbi etikën në trajnimin shkencor e kërkimor, etika në këshillimin shkencor për politikën, besimi te shkencën, shkeljet e etikës shkencore dhe plagjiatura.

Çështje të tjera adresuar së fundi janë edhe përdorimi i dyfishtë i rezultateve të kërkimit, aspektet etike të risqeve, shkencën dhe të drejtat e njeriut, mbështetja për arsimin e lartë dhe për kërkimin shkencor në Palestinë, kërkimi shkencor në embrionet njerëzore, biologjia sintetike, nanoteknologjia etj. Gjithashtu, grupi jep ekspertizë për projektin "ENER" financuar nga "Horizon 2020" (Rrjeti Europian për Etikën e Kërkimit dhe Integritetin e Kërkimit – European Network of Research Ethics and Research Integrity), që synon të trajtojë ekspertët në çështje që lidhen me etikën dhe të harmonizojë infrastrukturën e integritetit të kërkimit në mbarë Europën.

Grupi i Përhershëm i Punës i ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën mblidhet rregullisht dhe ka mbajtur edhe mbledhje tematike në mjedise më të gjera, veçanërisht në partneritete me organizata të tjera të lidhura me to, si Komisioni Europian, (Fondacioni Europian i Shkencës – European Science Foundation (ESF), the International Council for Science (ICSU), dhe UNESCO, ndër shumë të tjera. Anëtarët e Grupit të Përhershëm të Punës të ALLEA-s mbi Shkencën dhe Etikën u mbështetën mbi rrjetin e gjerë të ekspertëve dhe institucionet për realizimin me sukses të procesit të rishikimit të "Kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor".

Anëtarët e Grupit të Përhershëm të Punës të ALLEA-s

Göran Hermerén (Kryetar) – Royal Swedish Academy of Letters, History and Antiquities

Maura Hiney – Royal Irish Academy, Kryesues/e e grupit të hartimit të Kodit

László Fésüs – Hungarian Academy of Sciences, grupi i hartimit të Kodit

Roger Pfister – Swiss Academies of Arts and Sciences, grupi i hartimit të Kodit

Els Van Damme – Royal Academy of Sciences, Letters and Arts of Belgium, grupi i hartimit të Kodit

Martin van Hees – Royal Netherlands Academy of Arts and Sciences, grupi i hartimit të Kodit

Krista Varantola – Council of Finnish Academies, grupi i hartimit të Kodit

Anna Benaki – Academy of Athens (Greqi)

Anne Fagot-Largeault – Académie des Sciences (Francë)

Ludger Honnefelder – Union of the German Academies of Sciences and Humanities

Bertil Emrah Oder – Bilim Akademisi (Akademia e Shkencave, Turqi)

Martyn Pickersgill – Royal Society of Edinburgh (Mbretëri e Bashkuar)

Pere Puigdomenech – Royal Academy of Sciences and Arts of Barcelona / Institute for Catalan Studies (Spanjë)

Kirsti Strøm Bull – Norwegian Academy of Science and Letters

Zbigniew Szawarski – Polish Academy of Sciences

Raivo Uibo – Estonian Academy of Sciences

Mbështetja për Grupin e Përhershëm të Punës mbi Shkencën dhe Etikën të ALLEA-s dhe Grupin e Përpilimit të draftit: Robert Vogt (sekretariati i ALLEA-s)



ALLEA, Federata Europiane e Akademive të Shkencave dhe Studimeve Humane u themelua në 1994 dhe sjell bashkë 58 akademi në më shumë se 40 vende nga rajoni i Këshillit të Europës. Akademitë anëtare veprojnë si shoqëri të dijes, banka për gjenerim idesh dhe organizata që kryejnë kërkim shkencor. Ato janë komunitete vetëqeverisëse të udhëheqësve të kërkimit shkencor në të gjitha fushat e shkencave natyrore, shkencave sociale dhe shkencave humane.

Prandaj ALLEA siguron qasje në një burim njerëzor të pakrahasueshëm të eksperiencës, ekspertizës dhe ekselencës intelektuale. E pavarur nga interesat politikë, tregtarë dhe ideologjikë, politikat e ALLEA-s synojnë të kontribuojnë për të përmirësuar kushtet e kuadrit në të cilat mund të shkëlqejnë shkenca dhe studimi shkencor. Së bashku me akademitë anëtare, ALLEA është në gjendje të adresojë gamën e plotë të çështjeve strukturale dhe politikave me të cilat po përballet Europa në shkencë, kërkim dhe inovacion. Duke bërë këtë, ajo udhëhiqet nga mirëkuptimi i përbashkët për një Europë të bashkuar nga faktorë historikë, shoqërorë dhe politikë, si dhe për arsye shkencore dhe ekonomike.

www.allea.org

Akademitë anëtare

Albania: Akademia e Shkencave e Shqipërisë; **Armenia:** Գիտությունների ազգային ակադեմիա; **Austria:** Österreichische Akademie der Wissenschaften; **Belarus:** Нацыянальная акадэмія навук Беларусі; **Belgium:** Académie Royale des Sciences des Lettres et des Beaux-Arts de Belgique; Koninklijke Vlaamse Academie van België voor Wetenschappen en Kunsten; Koninklijke Academie voor Nederlandse Taal- en Letterkunde; Académie Royale de langue et de littérature françaises de Belgique; **Bosnia and Herzegovina:** Akademija nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine; **Bulgaristan:** Българска академия на науките; **Bulgaria:** Българска академия на науките; **Croatia:** Hrvatska Akademija Znanosti i Umjetnosti; **Czech Republic:** Akademie věd České republiky; Učená společnost České republiky; **Denmark:** Kongelige Danske Videnskabernes Selskab; **Estonia:** Eesti Teaduste Akadeemia; **Finland:** Tiedekatemiain neuvottelukunta; **France:** Académie des Sciences – Institut de France; Académie des Inscriptions et Belles-Lettres; **Georgia:** საქართველოს მეცნიერებათა ეროვნული აკადემია; **Germany:** Leopoldina - Nationale Akademie der Wissenschaften; Union der deutschen Akademien der Wissenschaften; Akademie der Wissenschaften in Göttingen, Akademie der Wissenschaften und der Literatur Mainz, Bayerische Akademie der Wissenschaften, Berlin-Brandenburgische Akademie der Wissenschaften, Akademie der Wissenschaften in Hamburg, Heidelberger Akademie der Wissenschaften, Nordrhein-Westfälische Akademie der Wissenschaften und der Künste, Sächsische Akademie der Wissenschaften zu Leipzig (Anwtar i Asociuars); **Greece:** Ακαδημία Αθηνών; **Hungary:** Magyar Tudományos Akadémia; **Ireland:** The Royal Irish Academy - Acadamh Ríoga na hÉireann; **Israel:** האקדמיה הלאומית הישראלית למדעים; **Italy:** Accademia Nazionale dei Lincei; Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti; Accademia delle Scienze di Torino; **Kosovo:** Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës; **Latvia:** Latvijas Zinātņu akadēmija; **Lithuania:** Lietuvos mokslų akademijos; **Macedonia:** Македонска Академија на Науките и Уметностите; **Moldova:** Academia de Științe a Moldovei; **Montenegro:** Crnogorska akademija nauka i umjetnosti; **Netherlands:** Koninklijke Nederlandse Akademie van Wetenschappen; **Norway:** Det Norske Videnskaps-Akademi; Det Kongelige Norske Videnskabers Selskab; **Poland:** Polska Akademia Umiejętności; Polska Akademia Nauk; **Portugal:** Academia das Ciências de Lisboa; **Romania:** Academia Română; **Russia:** Российская академия наук (Anwtar i Asociuar); **Serbia:** Srpska Akademija Nauka i Umetnosti; **Slovakia:** Slovenská Akadémia Vied; **Slovenia:** Slovenska akademija znanosti in umetnosti; **Spain:** Real Academia de Ciencias Exactas, Físicas y Naturales; Reial Acadèmia de Ciències i Arts de Barcelona; Institut d'Estudis Catalans; **Sweden:** Kungl. Vetenskapsakademien; Kungl. Vitterhets Historie och Antikvitets Akademien; **Switzerland:** Akademien der Wissenschaften Schweiz; **Turkey:** Türkiye Bilimler Akademisi; Bilim Akademisi; **Ukraine:** Національна академія наук України; **United Kingdom:** The British Academy; The Learned Society of Wales; The Royal Society; The Royal Society of Edinburgh

integrity | in'ti

1 the quality of being honest and having strong moral principles; *integrity*.

2 the state of being whole; *integrity*.

- the condition of being whole
- internal consistency

ALLEN

ALL European
Academies

